



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.101/2005

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore me gjyqtarin individual Naim Mehulli dhe me bashkëpunëtorin profesional Blerim istrefi, në çështjen juridike të paditësit: **TD** nga Rr....., kundër të paditurave: Komuna e, IPVK- me seli në dhe i dhe-u, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 150,000 €, me datën 01.02.2019, konform nenit 391 pika a) dhe nenit 399 te LPK-së, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit TD nga Rr....., me të cilën ka kërkuar që të obligohen të paditurit Komuna e dhe IPVK –....., që në emër të kompensimit të dëmit material, në mënyrë solidare t’ia paguajnë paditësit shumën e përgjithshme prej 150,000 €, me kamatë ligjore duke e llogaritur atë nga dita e parashtrimit të kësaj padie e deri në pagesën definitive, si dhe t’ia paguajnë shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, **si e pa bazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv** .
- II. HUDHET POSHTË si e palejuar** padia e paditësit, e parashtruar kundër të paditurit të tretë me seli nëdhe të paditurit të katërt -, me seli në
- III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Për këtë çështje juridike, bazuar në nenin 399 të LPK-së, gjykata vendosi pa mbajtur shqyrtim kryesor.

Paditësi me dt.18.01.2005, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurave, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e dëmit në shumën e përgjithshme prej 150.000 €, të cilën, sipas tij në mënyrë solidare duhet tia paguajnë paditësit.

Gjykata me dt.11.12.2018 të paditurve: të parë dhe të dytë e ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi.

Me parashtresën e datës 21.12.2018, përfaqësuesi i të paditurës së dytë si dhe me datë 03.01.2019 përfaqësuesi i te paditurës së parë kanë dorëzuar përgjigjen në padi,përmes të cilës e kontestojnë kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim së të paditurës së parë dhe të dytë i mungon legjitimiteti real-pasiv për të qenë palë në këtë ceshtje juridike krejtë kjo pasi që sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, përgjegjës për ta garantuar rendin dhe sigurinë në Kosovë, janë dhe-u. organet përgjegjëse për garantimin e rendit dhe sigurisë në Kosovë janë dhe-u,mbi këto arsye edhe është propozuar refuzimi i kërkesë padisë,shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.Andaj nga këto arsye edhe kanë propozuar refuzimin e kërkesëpadisë si të pa bazuar. Shpenzimet procedurale nuk i kanë kërkuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, shkresave të tjera të lëndës dhe përgjigjes në padi të përfaqësuesit të paditurës së parë dhe të dytë, e në kuptim të nenit 8 të LPK-se gjeti se: **kërkespafia e paditësit në raport me të paditurën e parë dhe të dytë duhet të refuzohet si e pa bazuar ndërsa në raport me të paditurën e tretë dhe të katërt hudhet poshtë për këto arsye:** në rastin konkret kemi të bëjmë me kompensimin e dëmit për të cilin paditësi pretendon se i është shkaktuar gjatë periudhës kur bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr.1244, përgjegjës për gjendjen e sigurisë në Kosovë, ka qenë dhe Në bazë të Rregullores se-ut nr....., të datës 25.06.1999, (neni 1) është e paraparë se *“i gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet dhe ushtrohet nga*”.

Është fakt notor se në këtë kohë (Qershor 1999 – tetor 2000), nuk kanë ekzistuar (IPVQ), qoftë në nivel qendror apo atë lokal. Të njëjtat janë themeluar tek në fund të vitit 2000, ku pas mbajtjes së zgjedhjeve të para demokratike në nivel lokal, me datën 28.10.2000, fillimisht ishin formuar organet e pushtetit lokal, e pastaj pas mbajtjes së zgjedhjeve nacionale me 17.11.2001, u formuan edhe ato të nivelit qendror. Me Rregulloren e nr.2000/45, të datës 11.8.2000, mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës (neni 1 dhe 2), mes tjerash, parashihet se **“me këtë Rregullore themelohen institucionet e përkohshme për vetëqeverisje autonome dhe demokratike në nivel komunal, si njësi themelore territoriale të qeverisjes lokale të cilat e ushtrojnë tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për pushtetin qendror”**. Në nenin 3 të po kësaj Rregulloreje, në mënyrë taksative parashihen përgjegjësitë e Komunës. Nga kjo, mes tjerash, rezulton edhe përfundimi se nuk ekziston suksesioni juridik në mes të ish komunave dhe komunave të themeluara pas vitit 2000 përmes Rregullores së-ut nr.2000/45. E njëjta gjë vlen edhe për Institucionet e , respektivisht Qeverinë e, përgjegjësitë e së cilës janë më afër të përshkruara në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e të cilat institucione qendrore, për herë të parë janë themeluar pas zgjedhjeve qendrore të mbajtura më 17.11.2001.

Duke qenë se paditësi e bazon kërkesëpadinë e tij në kohën e para themelimit të Komunave dhe IPVQ-ve, gjegjësisht periudhën në të cilën, siç edhe u cek më lartë, i gjithë pushteti legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor, si dhe ai i sigurisë në Kosovë ushtrohej nga dhe, stafi i të cilave gëzojnë imunitet dhe privilegje si personel ndërkombëtar, ndërsa të paditurit Komuna e dhe IPVK -ngase siç edhe u cek më lartë, këto institucione janë formuar shumë më vonë nga koha kur paditësit i është shkaktuar dëmi i pretenduar, padia e paditësit në raport me të paditurit Komuna e dhe – Qeveria e Kosovës, u deshtë të refuzohet si e pabazuar.

Në anën tjetër, me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2000/47, të datës 18.8.2000, për Statusin, Privilegjet dhe Imunitetin e,dhe personelit të tyre (neni 2 i kësaj rregulloreje), me tjerash, është paraparë se “.....-i, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tij janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor” e për rrjedhojë edhe nga juridiksioni i gjykatave në Kosovë. Me nenin 3 të po kësaj Rregulloreje gjithashtu parashihet se “.....u, prona e tij, fondet dhe pasuritë e tyre janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor”. Përfundimisht, me nenin 5 të kësaj Rregulloreje parashihet imuniteti i personelit të-ut dhe të-it, si dhe kohëzgjatja e këtij imuniteti, nga ku edhe del se-u dhe-i, nuk mund të jenë palë në këtë procedurë, andaj edhe padia e paditësit në raport me të paditurën e tretë (.....) dhe të të katërt (.....), u deshtë të hidhet poshtë si e palejuar.

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 391 pika (a) dhe 399, lidhur me nenin 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 450 të LPK-së, kjo për faktin se e paditura (përfshirë këtu edhe Komunën e) nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.101/2005, datë 01.02.2019

GJYQTARI,
Naim Mehulli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.